



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



---

## **E K S T R A K T**

**i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Komitetit konsultativ për personat më aftësi të kufizuara, mbajtur më 23.09.2022, duke filluar në orën 14:00.**

**Në mbledhje morën pjesë anëtarët e komitetit: Fatime Demolli-Mustafa, kryesuese, anëtarët e Komitetit: Ramadan Salihu, Gyltene Retkoceri, Mehreme Llumnica dhe Jeton Canhasi.**

**Mungoi: Ermira Shabani dhe Armend Ademi.**

**Në mbledhje ishte e pranishme edhe Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut.**

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli-Mustafa, me këtë**

### **R E N D D I T E:**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuara;**
- 2. Tetori, Dita ndërkombëtare e personave me shkop të bardhë;**
- 3. Takime me drejtorët lidhur me Planin e veprimit;**
- 4. Të ndryshme( Punëtorja e aftësisë së kufizuara ).**

**Pika e parë**

**Miratimi dhe shqyrtimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuara**

**Kryesuesja, konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit Konsultativ të Personave me Aftësi të Kufizuara.**

## **Pika e dytë**

### **Tetori, Dita ndërkombëtare e personave më shkop të bardhë**

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese, tha se po afrohet 15 tetori, Dita ndërkombëtare e personave me shkop të bardh, hapi diskutimin se si do të organizojmë këtë vit, nëse do të organizojmë kënd do e ftojmë, nëse i ftojmë si t'i ftojmë, ku do të mbahet, a do të këtë drekë nga Komuna po besoj se Premtimja na kishte ndihmuar në këtë pjesë.

**Premtime Preniqi**, sugjeroi që si Komitet me ju drejtuar drejtorit të Drejtorisë së Administratës, me kërkesë se çka doni me organizuar për këtë ditë dhe çka po doni faktikisht me bërë, një lloj agjente dhe me ftuar kryetarin, nënkryetaret, ku nënkryetari Zogaj ka shprehur gatishmëri në takimin që ka qenë se do të i përkrah PAK-ra, ku përveç 15 tetorit me kërkuar edhe një organizim të përgjithshëm për personat me aftësi të kufizuar.

**Mehreme Llumnica**, tha se nëse ndonjë p.sh. sindromi, autizmi, e kanë përvjetorin, është mirë me bashkëpunuar me organizatën lokale dhe ato me e bërë një aktivitet kurë është 3 dhjetori, dita ndërkombëtare e të gjitha llojeve të kufizuara e ajo ditë me qenë madhore.

**Premtime Preniqi**, sugjeroi me ju shkruar të gjitha organizatave që i përfaqëson PAK, që me marrë pjesë në aktivitete dhe me bashkëpunuar me ta.

**Mehreme Llumnica**, tha se kurë të jemi ne si komitet, kurë të prezantohet atje përfaqësuesi i komitetit besoj edhe ata nevojat i prezantojnë më ndryshe.

Po ashtu propozoi që të shtohet një iniciativë që me pasur Kryetari i Komunës, një këshilltare të aftësive të kufizuara, që enkas me bashkëpunuar me komitetin që kishte me i shtyrë gjërat, për ndryshe si komitet kemi me qenë shumë të mangët.

**Premtime Preniqi**, tha se KKPAAK, është nivel më i lartë se sa komitetet e tjera jo obligative se vetëm ky komitet paguhet si komitet obligative. Ju si komitet duhet me kërkuar prej Komunës, çka ka bërë për PAK-ra.

**Mehreme Llumnica**, tha se nëse kishte me qenë një këshilltar ne e kemi shumë më lehtë me ju drejtuar dhe me bashkëpunuar, mendoj deri sa të jetë një Plan Veprimi, për krejt sektorët e Komunës edhe për një grup të qytetarëve që kanë shumë nevojë, është një komitet pse mos me qenë një këshilltar te Kryetari që kishte me i shtyrë punët.

**Premtime Preniqi**, tha se mundesh me ju drejtuar drejtpërdrejt Kryetarit, nënkryetarëve, këshilltarit dhe kabinetit.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se si po vendosim për Ditën ndërkombëtare të personave me shkop të bardhë, a pe shënojmë këtë vit si vitet tjera që e kemi shënuar.

**Mehreme Llumnica**, tha se nëse e shënojmë me 15 tetor, atë ditë Organizatat e Shoqatës e të Verbërve lokale apo nivelit, këtë ditë nuk mundë të vijmë se kanë aktivitete shumë.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se ne mundemi me mbajte ndonjë datë tjetër si me 11-12- 13-14 tetor, vetëm me ja kushtuar kësaj ditë.

**Premtime Preniqi**, tha se nuk e ka vlerën nëse është ditë ndërkombëtare dhe e ka datën e caktuar ajo datë e hupë kuptimin.

**Ramadan Salihu**, tha se sa i përket Ditës ndërkombëtare të njeriut me shkop të bardhë nuk ka pse të ndryshohet kurë nuk kemi ide të reja nuk kemi nevojë me ndryshuar asgjë të mbetet i njëjtë si vitet paraprake. E ftojmë forumin e PAK-ra , avokatin e popullit, këta çka

merren me PAK-ra, po ashtu është e nevojshme ajo që ceku Premtimja, këtu mos me qenë zëri i debatit por me qenë çka po kërkojmë ne dhe çka ka bërë deri tani Komuna në bazë të PV-të. Komuna nuk mundet me dal jashtë Planit të Veprimit, në këtë rast po e shfrytëzojmë rastin ndoshta edhe i shkruaj në email por ata numrat mirë që i kanë bërë në autobusë por i kanë bërë vetëm në pjesën ballore dhe rrezikohet PAK-ra, duke i shikuar, ata nuk i kanë shikuar ashtu siç i kemi paraqitur në Planin e Veprimit, andaj duhet me kërkuar me i bërë edhe pjesën anësore këtu të hyrja.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se a pajtoheni që më 14 tetor, të organizojmë këtë takim, ora varësisht prej agjendës së Kryetarit, një herë po i drejtohem vetëm kabinetit të Kryetarit me email që me na treguar orën dhe a ju konvenon kjo datë.

**Premtime Preniqi**, tha se duhet me e njoftuar edhe Ermirën, për protokoll e dërgoni të Kryetari, nënkryetarët dhe ju informon Ermira për orën që ju konvenon.

### **Pika e tretë**

#### **Takimet me drejtorët lidhur me Planin e Veprimit**

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se kam menduar mbledhjen e radhës me i ftuar 2 apo 3 drejtorë në takim.

**Mehreme Llumnica**, tha se të kemi ndonjë takim me drejtorë siç e kemi pasur me PV-të.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se është mirë me i ftuar kurë të kemi takime të rregullta se nuk po funksionon takimi me drejtorë.

**Mehreme Llumnica**, tha se ma mirë me i ftuar në takime të rregullta së edhe atyre nuk po ju konvenon kur po na konvenon neve.

**Premtime Preniqi**, tha se është marrë një vendim faktikisht janë ndarë komplet punët, secila drejtori ka me i kontrolluar punët, me i mbikëqyrë lidhur me planin, janë kryer disa aktivitete në fillim dhe askush nuk ka kthyer asgjë se çka është zhvilluar në ato takime apo ku kanë mbetur.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se janë mbajtur një herë ato takime dhe nuk janë mbajtur të gjitha. Po ashtu informoi se ka informatë nga arsimi se është duke u përgatitur vendimi për pagimin e transportit të fëmijëve nëpër kopshte gjë që e shohë një arritje shumë të madhe.

Në fillim të muajt nëntor, ju shkruaj në grup se cilat drejtori i ftojme me raportuar për PV-të, ju lutem merrni pjesë në mbledhje i caktojmë nga 2 apo 3 drejtori, ju raportojmë për PV-të, i njoftojmë edhe me aneks planin.

**Mehreme Llumnica** tha se prej drejtorive që është ma urgjente me ftuar është DSHP-ke.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se vetëm më shkruani cilën drejtori me e ftuar nuk ka problem i ftojme.

### **Pika e katërt**

#### **Të ndryshme( Punëtorja e Aftësisë së Kufizuara )**

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se Forumi kosovar, i aftësive të kufizuara na ka pritur tre muaj për një punëtorë të tillë dhe më në fund më kanë lajmëruar se e kanë

anuluare për shkak së nuk është përgjigjur asnjë anëtarë i komitetit tjetër përveç meje që do të marrë pjesë dhe e kanë anuluar.

**Ramadan Salihu**, tha se nuk kanë pasur të drejtë ata me anuluar takimin, ata nuk e kanë ditur cila është struktura jonë ata pikërisht atë ditë e kanë organizuar me e pa si po veprojmë ne, kurë është paraqitur kryesuesja e komitetit nënkupton si me ju paraqit të gjithë nuk është me rëndësi sa njerëz shkojnë me rëndësi është çka propozojmë.

Po them ka qenë një nga takimet me të rëndësishme që është dashtë me pasur komiteti gjatë këtyre viteve, andaj kishte qenë mirë me pasur mundësi me rikuperua atë dhe mos me u anuluar, kishim mundur me mbajtur edhe në zyre, këtu në këtë sallë.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se unë mundem me biseduar me drejtorin Bujar dhe me i rikuperuar.

**Mehreme Llumnica**, tha se ka qenë kohë e pa përshtatshme, koha e pushimeve.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se për këtë arsye e kemi shtyrë deri në shtator, por asnjë nga anëtarët nuk është përgjigjur që do të vijë apo jo.

**Ramadan Salihu**, tha se mundësisht mos me u anuluar, sepse nuk ka pasur nevojë mu anuluar takimi pasi që kryesuesja është lajmëruar dhe është keq prej anës së tyre që e kanë anuluar takimin.

**Fatime Demolli - Mustafa**, kryesuese tha se mbase të bisedojë me kryetarin e Forumit të personave me aftësi të kufizuar nëse vendos me e mbajtur takimin ju informoi.

**Mehreme Llumnica**, tha se kur t'i ftojme drejtorët, ata që e kanë pasur fushën me ju parashtruar pyetje p.sh kush e ka pasur shëndetësinë me shtruar pyetjen se është përgatitur për atë.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:50.*

Procesmbajtësja:  
Shyhrete Islami

Kryesuesja e komitetit  
Fatime Demolli - Mustafa

